AAES
Albanian Association of Electricity Suppliers
Shoqata Shqiptare e Furnizuesve të Energjisë Elektrike

Nr. 1811 Prot

Tiranë, më 18/11/2026

DREJTUAR: ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE (ERE)
Z. PETRIT AHMETI
KRYETARI I BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE

Lënda: Paraqitja e komenteve dhe propozimeve mbi projekt-rregulloren "Për ndryshimin e furnizuesit të energjisë elektrike"

I nderuar z. Ahmeti,

Shoqata Shqiptare e Furnizuesve të Energjisë Elektrike (AAES), në vijim të ftesës për konsultim, përcjellë nëpërmjet shkresës suaj nr. 3151/1 Prot., datë 03.11.2026, për paraqitjen e komenteve mbi projekt-rregulloren "Për ndryshimin e furnizuesit të energjisë elektrike" (në vijim "Rregullorja"), dëshiron të shprehë vlerësimin e saj për nismën e ndërmarrë nga ERE për rregullimin e një prej proceseve me rëndësi të veçantë praktike dhe me ndikim të drejtpërdrejtë si në veprimtarinë e furnizuesve të energjisë elektrike, ashtu edhe në interesat e klientëve fundorë.

Në vlerësimin e AAES-së, Rregullorja përbën një bazë të rëndësishme për standardizimin dhe lehtësimin e procedurës së ndryshimit të furnizuesit. Megjithatë, vlerësojmë se disa dispozita të saj kërkojnë qartësim dhe plotësim të mëtejshëm, me qëllim garantimin e sigurisë juridike, përcaktimin e qartë të përgjegjësive të palëve dhe sigurimin e zbatueshmërisë efektive të procedurave në praktikë.

Në këtë kuadër, AAES paraqet komentet dhe propozimet e mëposhtme:

1. Neni 5, pika 4 – Tarifa e përfundimit të parakohshëm të kontratës

Neni 5, pika 4, parashikon mundësinë e aplikimit të tarifës së përfundimit të parakohshëm të kontratës për klientët që nuk përfitojnë nga përjashtimet e parashikuara në këtë nen, duke përcaktuar ndër të tjera se zbatimi i saj i nënshtrohet rregullave dhe metodologjisë së miratuar paraprakisht nga ERE.

Në këtë drejtim, AAES vlerëson se është e nevojshme që ERE të ndërmarrë sa më parë hartimin dhe miratimin e metodologjisë përkatëse, me qëllim përcaktimin e kritereve dhe mënyrës së llogaritjes së tarifës së përfundimit të parakohshëm.

2. Nenet 5 dhe 7 – Detyrimet financiare dhe të drejtat kontraktore

AAES sugjeron plotësimin dhe qartësimin e dispozitave të neneve 5 dhe 7, duke synuar garantimin e sigurisë juridike në marrëdhëniet kontraktore ndërmjet klientit fundor, furnizuesit aktual dhe furnizuesit të ri.

Në veçanti, duhet të parashikohet shprehimisht se ndryshimi i furnizuesit nuk sjell shuarjen ose transferimin automatik të detyrimeve financiare të papaguara të klientit ndaj furnizuesit aktual. Gjithashtu, marrja përsipër e këtyre detyrimeve nga furnizuesi i ri duhet të realizohet vetëm në bazë të një marrëveshjeje të shprehur ndërmjet furnizuesve dhe me pëlqimin e shprehur të furnizuesit të ri.

Ky qartësim është i nevojshëm për të shmangur interpretime të ndryshme të dispozitave, për të garantuar respektimin e marrëdhënieve kontraktore ekzistuese dhe për të shmangur transferimin e detyrimeve financiare te një subjekt që nuk ka dhënë pëlqimin për marrjen e tyre përsipër.

Për këtë qëllim, AAES propozon:

a) Shtimin e një pike të re 6 në Nenin 5, me këtë formulim:

SHOQATA SHQIPTARE AAES Albanian Association of Electricity Suppliers ELEKTRIKE

"6. Ndryshimi i furnizuesit nuk cenon detyrimet financiare dhe të drejtat kontraktore të lindura të klientit ndaj furnizuesit aktual deri në datën e përfundimit të furnizimit. Çdo transferim i këtyre detyrimeve te furnizuesi i ri mund të realizohet vetëm në bazë të një marrëveshjeje të shprehur ndërmjet furnizuesit aktual dhe furnizuesit të ri, me pëlqimin e shprehur të furnizuesit të ri."

b) Riformulimin e Nenit 7, pika 2, shkronja "c", si më poshtë:

"c) Ekziston një marrëveshje e shprehur dhe e dokumentuar ndërmjet furnizuesit aktual dhe furnizuesit të ri, sipas së cilës furnizuesi i ri, me pëlqimin e tij të shprehur, merr përsipër detyrimet e papaguara të klientit."

Gjithashtu, sugjerohet të shtohet një dispozitë sqaruese në këtë pikë, sipas së cilës detyrimet financiare të klientit ndaj furnizuesit aktual nuk shuhen dhe nuk transferohen automatikisht si pasojë e ndryshimit të furnizuesit.

3. Neni 8, pika 2 – Dokumentacioni i ngarkuar në platformën elektronike

Neni 8, pika 2, parashikon detyrimin e furnizuesit të ri për të paraqitur në platformë konfirmimin e pranimit të klientit dhe dokumentacionin e nevojshëm për realizimin e furnizimit, përfshirë kontratën e furnizimit.

Në këtë drejtim, AAES vlerëson se kontrata e furnizimit që ngarkohet në platformën elektronike duhet të jetë e redaktuar (me të dhënat konfidenciale të mbuluara ose të anonimizuara), për aq sa këto të dhëna nuk janë të nevojshme për realizimin dhe administrimin e procedurës së ndryshimit të furnizuesit.

Kjo kërkesë synon mbrojtjen e informacionit tregtar dhe kontraktor me karakter konfidencial ose sensitiv, duke shmangur ekspozimin e kushteve ekonomike dhe të të dhënave të tjera që nuk janë të domosdoshme për qëllimin e procedurës.

4. Neni 10, pika 1 – Afatet e procedurës së ndryshimit të furnizuesit

Neni 10, pika 1, përcakton një afat maksimal prej 3 (tre) javësh për përfundimin e procedurës së ndryshimit të furnizuesit, nga data e paraqitjes së kërkesës së klientit.

AAES vlerëson se, krahas përcaktimit të afatit maksimal, është e nevojshme të përcaktohen edhe afatet ndërmjetëse për secilën fazë të procedurës, në mënyrë që të qartësohen detyrimet dhe përgjegjësitë e furnizuesit aktual, furnizuesit të ri dhe operatorit të sistemit.

Në veçanti, duhet të përcaktohen afatet brenda të cilave furnizuesi aktual ose operatori i sistemit mund të refuzojnë kërkesën, afatet për paraqitjen dhe ngarkimin e dokumentacionit përkatës, përfshirë dokumentacionin që provon statusin e detyrimeve financiare të klientit, si dhe afati brenda të cilit operatori i sistemit duhet të kryejë verifikimin dhe miratimin përfundimtar.

Gjithashtu, Rregullorja duhet të trajtojë shprehimisht rastet kur furnizuesi aktual ose operatori i sistemit nuk kryen veprimet përkatëse brenda afateve të përcaktuara, si dhe rastet e mosfunksionimit ose padisponueshmërisë së platformës elektronike.

Për këtë qëllim, AAES propozon që procedura të konkretizohet përmes përcaktimit të afateve të mëposhtme:

i. Nga momenti i regjistrimit të kërkesës për ndryshimin e furnizuesit, furnizuesi aktual dhe/ose operatori i sistemit duhet të kryejnë verifikimet përkatëse dhe, në rast se konstatohen shkaqe ligjore ose teknike për refuzimin e kërkesës, ta refuzojnë atë jo më vonë se 7 (shtatë) ditë kalendarike nga data e paraqitjes së saj, duke paraqitur në platformë arsyetimin përkatës dhe bazën ligjore ose faktike të refuzimit.

ii. Në rast se furnizuesi aktual dhe/ose operatori i sistemit nuk shprehen brenda afatit 7-ditor, kërkesa të konsiderohet e pranuar për efekt të përfundimit të fazës përkatëse të verifikimit, pa cenuar detyrimet e tjera ligjore të palëve. Furnizuesi aktual duhet të ngarkojë në platformë informacionin ose dokumentacionin përkatës mbi statusin e detyrimeve financiare të klientit, përfshirë vërtetimin e shlyerjes së detyrimeve, kur këto janë shlyer.

iii. Pas përfundimit të fazës së verifikimit, furnizuesi i ri duhet të kryejë aplikimin për regjistrimin e klientit të ri në platformë brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike dhe të ngarkojë dokumentacionin e plotë të kërkuar brenda afatit të përcaktuar në platformë, në mënyrë që procedura të përfundojë brenda afatit maksimal ligjor prej 3 (tre) javësh.

iv. Operatori i sistemit duhet të kryejë verifikimin e dokumentacionit të paraqitur dhe të miratojë regjistrimin e klientit jo më vonë se 4 (katër) ditë kalendarike nga data e ngarkimit të dokumentacionit të plotë nga furnizuesi i ri.

v. Në rastet kur platforma elektronike nuk është e disponueshme, duhet të parashikohen procedura alternative për komunikimin dhe shkëmbimin e dokumentacionit ndërmjet palëve, përfshirë përdorimin e komunikimit me postë elektronike (e-mail). Dokumentacioni dhe veprimet e kryera gjatë kësaj periudhe duhet të regjistrohen në platformë menjëherë pas rikthimit të funksionalitetit të saj.

Për këtë rast, duhet gjithashtu të përcaktohet mënyra e trajtimit të afateve procedurale gjatë periudhës së ndërprerjes, në mënyrë që mosfunksionimi i platformës të mos sjellë pasoja negative për klientin ose palët që nuk kanë përgjegjësi për ndërprerjen.

AAES vlerëson se përcaktimi i këtyre afateve dhe mekanizmave do të shmangte vonesat e pajustifikuara, do të rriste transparencën e procesit dhe do të garantonte një procedurë të parashikueshme dhe efektive për të gjithë pjesëmarrësit.

5. Neni 20 – Dispozita kalimtare dhe testimi i platformave elektronike

Neni 20 parashikon detyrimin e OST-së dhe OSSH-së për të përshtatur platformat elektronike me kërkesat e Rregullores dhe për të vënë në dispozicion të ERE-s dokumentacionin përkatës mbi funksionalitetet e tyre.

Ky detyrim merr rëndësi të veçantë në rastet kur platformat ekzistuese i nënshtrohen ndryshimeve të konsiderueshme teknike ose funksionale, të cilat mund të ndikojnë në procesin e aplikimit, komunikimit, verifikimit dhe përfundimit të procedurës së ndryshimit të furnizuesit.

Për këtë arsye, propozojmë që Neni 20 të plotësohet duke parashikuar se OST-ja dhe OSSH-ja duhet të kryejnë testimin e platformave përpara vënies në përdorim të ndryshimeve të rëndësishme, si dhe testime periodike gjatë funksionimit të tyre, me qëllim verifikimin e përmbushjes së kërkesave teknike, operacionale dhe të sigurisë.

Në përfundim, AAES rithekson mbështetjen e saj për nismën e ERE-s për rregullimin e procedurës së ndryshimit të furnizuesit të energjisë elektrike, duke e konsideruar atë një hap të rëndësishëm drejt funksionimit më transparent, konkurrues dhe efektiv të tregut të energjisë elektrike.

Njëkohësisht, vlerësojmë se reflektimi i komenteve dhe propozimeve të mësipërme do të kontribuonte në krijimin e një kuadri rregullator më të plotë, të qartë dhe të zbatueshëm, duke garantuar përcaktimin e qartë të të drejtave dhe detyrimeve të palëve, sigurinë juridike të marrëdhënieve kontraktore, trajtimin e barabartë të furnizuesve dhe funksionimin e pandërprerë e të sigurt të procedurës së ndryshimit të furnizuesit.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin dhe për mundësinë e dhënë për të kontribuar në këtë proces konsultimi, mbetemi të gatshëm për të ofruar çdo sqarim apo kontribut të mëtejshëm që mund të konsiderohet i nevojshëm.

Shoqata Shqiptare e Furnizuesve të Energjisë Elektrike

Lutemi që komentet dhe propozimet tona të merren në konsideratë gjatë shqyrtimit dhe miratimit të Rregullores.

Ju falënderojmë paraprakisht.

Me respekt,

SHOQATA SHQIPTARE E FURNIZUESVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE
(AAES)

KRYETARI
Olsi TURABI